

L I G J
Nr.8072, datë 15.2.1996

PËR ZONAT E LIRA

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon krijimin e zonave të lira, mënyrën e përcaktimit të trojeve dhe kufijve, administrimin, përcaktimin e objekteve të veprimtarive dhe shfrytëzimin e tyre, me qëllim që të zhvillohen investimet e reja dhe prodhimi për eksport, të shpejtohen hyrjet e mallrave dhe kapitaleve, të futet teknologjia e përparuar, të krijohen vende të reja pune dhe të përfitohet nga mundësitë e financimeve të huaja dhe shkëmbimeve tregtare.

Neni 2

Përkufizime

Për zbatimin e këtij ligji termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- “Zonë e lirë” kuptohen sipërfaqe terrenesh, ndërtesash e objektesh të veprimtarive tregtare, prodhuese e të shërbimeve, të cilat konsiderohen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe drejtohen në bazë të dispozitave të këtij ligji.

- “Zhvillues” është subjekti privat a shtetëror, vendas ose i huaj, i cili zhvillon funksionimin e zonës së lirë.

- “Përdorues” është subjekti privat a shtetëror, vendas ose i huaj, i pajisur me lejen përkatëse dhe që ushtron veprimtari ekonomike në zonën e lirë.

Neni 3

Llojet e zonave të lira

Zonat e lira në territorin e Republikës së Shqipërisë janë territore të caktuara ku zhvillohen veprimtari tregtare, industriale, të përpunimit për eksport, magazinave tranzite, të veprimtarive bankare e financiare, të shërbimeve, të duty free shop dhe veprimtarive ekonomike të ngjashme me to dhe ngrihen pranë porteve, aeroporteve e zonave të veçanta në nyjet e transportit ndërkombëtar.

KREU II
ORGANIZIMI I ZONAVE TË LIRA

Neni 4

Parimet e organizimit të zonave të lira

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë rast pas rasti trojet dhe kufijtë e zonave të lira në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli i Ministrave mbi bazën e dokumentacionit përkatës miraton krijimin si dhe veprimtaritë ekonomike që do të zhvillohen në zonat e lira.

Neni 5

Enti Kombëtar i Administrimit të Zonave të Lira

Për administrimin e zonave të lira krijohet Enti Kombëtar i Administrimit të Zonave të Lira.

1. Enti është person juridik, me qendër në Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrat sipas legjislacionit në fuqi.

2. Këshilli Drejtues i Entit përbëhet prej pesë anëtarësh që do të caktohen: tre nga Kuvendi Popullor dhe dy nga Këshilli i Ministrave. Kryetari i Këshillit Drejtues zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

3. Këshilli Drejtues mblidhet sa herë është e nevojshme dhe gjithnjë jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të afatit të mandatit të një anëtari të Këshillit Drejtues të Entit.

4. Kur mbetet bosh vendi i një anëtari të Këshillit Drejtues, atëherë ai zëvendësohet nga organi që e ka caktuar dhe kur mbetet bosh vendi i kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit, ky këshill zgjedh kryetarin sipas nenit 5, pika 2, të këtij neni.

5. Kryetari i parë i Këshillit Drejtues i caktuar nga Këshilli i Ministrave do të vazhdojë në këtë detyrë për një periudhë prej pesë vjetësh që nga krijimi i Entit. Vazhduesit e kryetarit dhe të anëtarëve të parë do të caktohen për një periudhë prej katër vjetësh që nga data e përfundimit të afatit të paraardhësve të tyre, me përjashtim të rastit kur një person caktohet të zërrë një vend bosh, që hapet para se të mbarojë afati i paraardhësit të tij. Në këtë rast ky person caktohet vetëm për periudhën e mbetur.

6. Asnjë anëtar nuk caktohet të shërbejë në Këshillin Drejtues të Entit për më tepër se dy afate të plota.

Neni 6

Heqja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Entit

1. Organi i emërtesës mund të heqë nga detyra çdo anëtar të Këshillit Drejtues të Entit që:

- a) rezulton se sëmuret mendërisht;
- b) gjykohet se gjatë veprimtarisë së tij rezulton i paafte për kryerjen e detyrave të ngarkuara;
- c) dënohet penalisht.

2. Kur merret një vendim për largimin në vend të anëtarit të hequr, caktohet një anëtar tjetër, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Neni 7

Kompetencat e Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira

Enti Kombëtar i Administrimit të Zonave të Lira ka këto kompetenca:

- Harton rregulloren për organizimin dhe administrimin e zonave të lira e formularët përkatës, si dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

- Shqyrton kërkesat e paraqitura nga personat juridikë, privatë e shtetërorë (zhvilluesi), brenda 30 ditëve dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

- Përcakton qiratë e tarifatat për kontratat që do të lidhen ndërmjet Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira dhe zhvilluesit dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

- Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave lidh kontratën me zhvilluesin, ku përcaktohen kushtet e dhënies me qira të trojeve, objekteve dhe instalimeve si dhe afatet kohore të përdorimit.

- Shqyrton kërkesat e paraqitura nga përdoruesit e zonës së lirë dhe miraton veprimtarinë dhe afatet kohore të veprimit në zonën e lirë.

- Planifikon fondin përkatës për çdo zonë të lirë dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

- Përcakton strukturën organizative dhe organikën e drejtorisë së zonës së lirë ku zhvilluesi është objekt shtetëror.

- Në rastet kur zhvilluesi është subjekt privat, cakton një përfaqësues të tij në zonën e lirë, i cili do të ketë detyrën e koordinatorit.

Neni 8

Roli i kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit

1. Kryetari vepron si titullar i Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira.
2. Njëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues caktohet si nënkryetar dhe, në mungesë të kryetarit, përmbush dhe ushtron të drejtat dhe detyrat e tij.

Neni 9

Shpërblimi dhe kushtet e shërbimit

1. Pagat e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Entit caktohen nga Këshilli i Ministrave
2. Gjatë afatit të kryerjes së detyrave, asnjë nga anëtarët e Këshillit Drejtues nuk lejohet të ushtrojë veprimtari biznesi, direkt apo indirekt, në zonat e lira. Ky kufizim shtrihet edhe mbi pjesëtarët e familjes së tij.

Neni 10

Personeli dhe këshilltarët e Këshillit Drejtues

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Këshilli Drejtues ka të drejta të plota të zgjedhë, të ngrejë apo të ulë në detyrë, të përcaktojë pagat e punonjësve që përbëjnë personelin profesionist për kryerjen e funksioneve të Entit.
2. Këshilli Drejtues i Entit përcakton rregullat e punësimit në Ent të specialistëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Këshilli Drejtues i Entit ka autoritet ekskluziv për të përcaktuar strukturën dhe organizimin e personelit profesionist të Entit.
4. Përveç punonjësve profesionistë Këshilli Drejtues i Entit, sipas nevojës, herë pas herë, mund të punësojë specialistë ose këshilltarë që i nevojiten për kryerjen e funksioneve të tij.

Neni 11

Drejtoria e Administrimit të Zonës së Lirë

Çdo zonë e lirë administrohet, drejtohet dhe kontrollohet nga drejtoria e zonës së lirë, e cila varet nga Enti Kombëtar i Administrimit të Zonave të Lira.

Drejtoria e Administrimit të Zonave të Lira e zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të veçanta të nxjerra nga Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira.

Drejtori i zonës së lirë emërohet nga Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira. Zgjedhja e tij bëhet me shumicë votash.

Drejtoria e administrimit të zonës së lirë ka këto kompetenca:

- administrimin e zonës së lirë në përputhje me legjislacionin e zonave të lira;
- regjistrimin e personave fizikë e juridikë që kanë marrë leje për ushtrim veprimtarie në zonën e lirë;
- arkëtimin e derdhjeve në llogarinë përkatëse të fondit dhe kryerjen e shpenzimeve nga ky fond sipas buxheteve vjetore të caktuara nga Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira;
- sigurimin e koordinimit të nevojshëm në zonën e lirë për funksionimin e shërbimeve publike si dogana, rendi publik, puna, sigurimet shoqërore, instalimet e infrastrukturës dhe shëndetësia.
- mbikëqyrjen dhe kontrollin e operacioneve të kryera në përputhje me kushtet e kontratës të shfrytëzimit, të lidhura me zhvilluesin e zonës së lirë dhe me kushtet e kontratave të lidhura ndërmjet zhvilluesit dhe përdoruesve, që mund të jenë subjekt shtetëror a privat;
- dhënien e lejeve të hyrjes në zonën e lirë dhe sigurimin e kontrollit për to;
- marrjen e kërkesave dhe dhënien e lejeve të qendrimit;
- përgatitjen e llogarive vjetore dhe të raporteve të nevojshme të kërkuara nga Këshilli

Drejtues i Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira;

- regjistrimin e mosmarrëveshjeve dhe padive, sigurimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mirëkuptim dhe transmetimin e tyre autoriteteve të interesuara.

Neni 12

Marrëdhëniet me zhvilluesin dhe përdoruesit

Trualli dhe objektet e nevojshme për zonën e lirë të miratuar blihen ose shpronësohen në bazë të dispozitave ligjore për shpronësimet për qëllime publike.

Personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj, kanë të drejtë të zhvillojnë veprimtari ekonomike në zonën e lirë pasi të jenë pajisur me lejen përkatëse nga Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira. Për këtë qëllim ky Ent lidh kontratë me zhvilluesin, ku përcaktohen kushtet e dhënies me qira të trojeve, objekteve dhe instalimeve, si dhe afatet kohore të përdorimit. Me përfundimin e afatit të përcaktuar në kontratë, investimet e bëra nga zhvilluesi dhe investuesi brenda zonës së lirë mbeten në pronësi të shtetit që përfaqësohet nga Enti Kombëtar i Administrimit të Zonave të Lira, në rast se nuk ka kërkesë për ripërtëritje të kontratës prej tij.

Për të gjitha problemet që lidhen me përdorimin e trojeve, me projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e ndërtesave dhe instalimeve, zhvilluesi lidh kontratë me përdoruesit në zonën e lirë.

Zona e lirë e fillon veprimtarinë e saj pas përfundimit të ndërtimit të kufijve rrethues dhe të portave të hyrjes e të daljes, si dhe të fillimit të funksionimit të drejtorisë së zonës, të organeve doganore dhe të rendit publik.

Sigurimi i rendit publik dhe i qetësisë, si dhe shërbimi i ruajtjes së kufijve të zonës, kryhen nga organet e rendit publik.

Neni 13

Përfundimet nga taksat dhe lehtësitë

Në zonat e lira nuk zbatohen dispozitat ligjore për taksat doganore, akcizat, tatimi mbi qarkullimin ose tatimi mbi vlerën e shtuar.

Mallrat që hyjnë në zonën e lirë ose që dalin prej saj përjashtohen nga detyrimet e mësipërme, por i nënshtrohen kontrollit e dokumentimit doganor sipas dispozitave në fuqi.

Personat juridikë që veprojnë në zonën e lirë përfitojnë të gjitha përjashtimet dhe lehtësitë tatimore nga ligji “Për tatimin mbi fitimin”. Këto përjashtime e lehtësi përfitohen jo vetëm nga veprimtaritë prodhuese, por edhe nga veprimtaritë tregtare e ato të shërbimit dhe, nga ana tjetër, përjashtimi i plotë nga tatimi mbi fitimin shtrihet në shtatë vjetët e parë të ushtrimit të çdo lloji veprimtarie në zonën e lirë.

Neni 14

Fondi për krijimin dhe zhvillimin e zonave të lira

Këshilli i Ministrave cakton çdo vit një fond për Entin Kombëtar të Administrimit të Zonave të Lira, me qëllim që të mbështetet krijimi i zonave të lira, mirëmbajtja dhe riparimi në to, zhvillimi i tyre, kryerja e kërkimeve shkencore përkatëse, kualifikimi dhe veprimtaritë sociale, si dhe nxitja e përdoruesve.

Në burimet e fondit përfshihen:

- Kontributi nga buxheti i shtetit.

- Pagesat e arkëtuara për dhënien e lejeve të veprimtarisë dhe autorizimeve.

- Pagesat e parashikuara nga kontratat e lidhura me personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në zonat e lira.

- Të ardhura të tjera.

Procedura për derdhjet dhe shpenzimet nga fondi përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III MALLRAT E SHËRBIMET

Neni 15

Mallrat

Tregtia ndërmjet zonës së lirë dhe territorit doganor të vendit i nënshtrohet regjimit të eksport-importit. Ky regjim nuk zbatohet për tregtinë ndërmjet zonave të lira, si dhe ndërmjet zonave të lira dhe shteteve të tjera.

Neni 16

Hyrja e mallrave

Në zonat e lira hyjnë të gjitha mallrat pavarësisht nga natyra, cilësia, origjina, prejardhja ose destinacioni i tyre.

Nuk lejohet futja e mallrave që shkaktojnë prishjen e moralit e të rendit publik, që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, mjedisin, kafshët dhe bimët, pasuritë kombëtare si dhe pasuritë industriale e tregtare.

Organet doganore kërkojnë vende të veçanta për vendosjen e mallrave, të cilat paraqesin rrezik ose që shkaktojnë prishjen e mallrave të tjera.

Neni 17

Dalja e mallrave

Mallrat që dalin nga zonat e lira:

- eksportohen jashtë territorit doganor shqiptar;
- futen në territorin doganor shqiptar, duke u vendosur në regjimin doganor të tij.

Për mallrat që paraqiten për konsum brenda vendit dhe kur ato janë përfituar pas përpunimit në zonë të lirë me komponentë përbërës të produkteve të marra nga tregu i brendshëm, me kusht që këto produkte të jenë të regjistruara nga organet doganore para futjes së tyre në zonën e lirë, vlera dhe dhe sasia e këtyre produkteve zbriten nga vlera dhe sasia që i nënshtrohen detyrimeve doganore kur dalin nga zona e lirë.

Neni 18

Pagesat dhe shërbimet

Pagesat që lidhen me veprimtaritë e zhvilluara në zonën e lirë, kryhen me monedhë të huaj ose me monedhë të vendit.

Shërbimet e ndryshme të kërkuara në zonën e lirë kryhen nga zhvilluesi ose nga subjekte të tjera shtetërore a private të ngarkuara për këtë qëllim nga zhvilluesi.

Neni 19

Kontabiliteti

Të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonën e lirë, mbajnë një kontabilitet të shkruar në bazë të dispozitave të ligjit “Për kontabilitetin”.

Ky kontabilitet vihet në dispozicion të organeve doganore e tatimore, me qëllim që t’u lejojë atyre të ushtrojnë kontroll sa herë që e quajnë të nevojshëm.

KREU IV

Neni 20

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në zonën e lirë rregullohen në bazë të legjislacionit të punës në

Republikën e Shqipërisë, si dhe të dispozitave në fuqi për migracionin.

Këshilli i Ministrave cakton kushte të veçanta të punësimit, kohës së punës dhe pushimit në zonat e lira.

Neni 21

Sigurimet shoqërore

Në zonën e lirë zbatohen dispozitat e legjislacionit të Republikës së Shqipërisë për sigurimet shoqërore.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Në rast mosmarrëveshjesh ndërmjet përdoruesve dhe zhvilluesit apo organizmave të tjerë, palët bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhje me bisedime. Në rast të kundërt palët i drejtohen, sipas rastit, gjykatës kompetente, e cila ka në juridiksion zonën e lirë, ose Qendrës për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve për Investimet (konventa ICSID).

Neni 23

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për zbatimin e këtij ligji dhe përgatitjen e akteve përkatëse për zonat e lira .

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1390, datë 29.2.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha